

**" Dëgjimi, e folura... dhe alfabeti me ngjyra".** Një koncept për Fonetikën dhe Fonologjinë e gjuhës gjermane

Më 21 mars 2024, **Grupi Mësimor-Kërkimor Gjuhë dhe Komunikim i Departamentit të Gjermanishtes** (Prof. dr. Brikena Kadzadej), organizoi një shkëmbim shkencor online në sallën "Europa" në bashkëpunim me Universitetin e Würzburgut, linguistin Dr. Oliver Herbst dhe artistit të njohur gjerman Stefan Reiss.

Tema e shkëmbimit: " Dëgjimi, e folura... dhe alfabeti me ngjyra".

Një koncept për Fonetikën dhe Fonologjinë e gjuhës gjermane

Gjuhëtari Dr. Oliver Herbst nga Universiteti i Würzburgut dhe artisti Stefan Reiss prezantuan projektin e tyre për alfabetin me ngjyra të gjuhës gjermane, një mundësi për një perceptim dhe transmetim më të arrirë të fonetikës dhe fonologjisë të gjuhës gjermane, me rëndësi për gjermanishten si gjuhë e huaj.

Shpesh ka mangësi në kompetencën gjuhësore të studentëve gjatë të folurit dhe të shkruarit. Ky Projekt synon të mbështesë studentët, ata që mësojnë gjermanisht në përmirësimin e aftësive të tyre të të dëgjuarit dhe të folurit.

Qëllimi është një platformë interaktive mësimore dixhitale që ka si qëllim t'i bëjë tingujt të dukshëm me ngjyra dhe të ilustron ndryshimet dhe ngjashmëritë midis tingujve.

Platforma e të mësuarit po ashtu ka si qëllim krijimin e rrjetit të pedagogëve dhe të studentëve në mënyrë digjitale dhe të inkurajojë diskutimin në këtë fushë.

Kjo platformë mund të ofrojë gjithashtu hapësirë për veçoritë rajonale dhe mbi këtë bazë të lehtësojë përvetësimin e gjuhës si qëllim.

Në këtë shkëmbim morën pjesë studentë të Bachelorit, të Masterit "Mësuesi" dhe pedagogë të gjuhës gjermane. Në fund të këtij shkëmbimi u vendos vijimi i bashkëpunimit midis studentëve dhe pedagogëve të të dy universiteteve.

